

PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Shoqëria civile e zhvilluar është bazë e një demokracie të mirëfilltë. Shoqëria civile ka rol të rëndësishëm në hartim dhe zbatim të politikave sidomos në kuadër të procesit të integrimit evropian. Rëndësia e bashkëpunimit me shoqërinë civile është vënë në pah me futjen e nenit 11 në Traktatin e Lisbonës të Bashkimit Evropian në të cilin theksohet rëndësia e dialogut civil, si dhe me kushtëzimin nga ana e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor që të stimulojnë këtë dialog në mënyrë që shoqëria civile të ushtrojë rolin e saj në këtë proces dhe të ngris nivelin e përfaqësimit demokratik të shoqërisë. Në Kosovë pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e integrimit evropian zhvillohet në dy platforma, në atë të bashkëpunimit shoqëri civile – institucione të BE-së dhe shoqëri civile -institucione vendore.

MEKANIZMAT DHE STRUKTURAT E BASHKËPUNIMIT SHOQËRI CIVILE – INSTITUCIONE TË BE-SË

Komunikata e Komisionit Europian e vitit 2009 “Kosova – Përmbushja e Perspektivës Europiane” propozoi një dialog politik të intensifikuar, i quajtur **Dialogu i procesit të Stabilizim – Asociimit (DpSA)**. Ky dialog zhvillohet në rrafshin politik dhe atë teknik (sektorial). Qëllimi kryesor i takimeve politike dhe teknike në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit është për të përcjellur dhe monitoruar reformat e Kosovës dhe procesin e përafrimit me BE-në. Në kuadër të dialogut politik, për çdo vit OShC-të ftohen në një takim i cili zhvillohet një ditë para seancës plenare të DpSA-

së, ku ato kanë mundësi të japin vlerësimet dhe shqetësimet e tyre për zhvillimet e fundit, ndërsa përfaqësuesit e KE-së këto pyetje dhe çështje i ngrisin zyrtarisht gjatë takimit zyrtar plenar mes KE-së dhe autoriteteve kosovare.

Në nivel teknik ekzistojnë shtatë takime sektoriale mes autoriteteve të Kosovës dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian. Që nga viti 2011 OShC-të ftohen dhe kontribuojnë me ekspertizën e tyre varësisht nga fushat që diskutohen në takime të veçanta sektoriale në mes të KE-së dhe shoqërisë civile. Mekanizëm tjetër i bashkëpunimit është kontributi i OSHC-ve për **Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën**. Që nga viti 2005 KE-ja rregullisht monitoron progresin e arritur në Kosovë përmes raporteve vjetore të progresit. Raporti i Progresit përshkruan shkurt marrëdhëniet mes Kosovës dhe BE-së si dhe vlerëson të arriturat në bazë të 3 kriterëve të Kopenhagës: politike, ekonomike dhe standardet europiane.

INSTRUMENTI I ASISTENCËS SË PARA-ANËTARSIMIT (IPA)

Instrument i Komisionit Europian i cili ka për qëllim asistencën teknike drejtuar vendeve me perspektivë anëtarësimi. Zyra e BE-së në Kosovë i konsulton OShC-të për përshkrime të projekteve përmes një Komisioni të Përbashkët të Monitorimit për të siguruar efikasitetin më të mirë të ndihmës dhe shmangien e duplikimeve. Gjithashtu, shoqëria civile konsultohet edhe gjatë programimit të **Dokumentit Indikativ për Planifikim Shumëvjeçar (MIPD)** si dhe **Planeve vjetore për asistencë nga IPA për Kosovën**, e poashtu edhe asistencës direkte për shoqërinë civile qoftë përmes IPA apo instrumentit EIDHR rajonal apo të Kosovës.

Zyra e BE-së në Kosovë për çdo vit i fton OShC-të kosovare që të japin kontributin e tyre për fusha të ndryshme të cilat mbulohen nga Raporti i Progresit dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në prezantimin e pasqyrës reale të progresit dhe sfidave të vendit.

MEKANIZMAT DHE STRUKTURAT E BASHKËPUNIMIT SHOQËRI CIVILE- INSTITUCIONE VENDORE

Format kryesore ku organizatat e shoqërisë civile marrin pjesë në procesin e integrimi europiane në bashkëpunim me insitucionet vendore janë: 1) Këshilli Kombëtar për Integrimi Europiane, 2) Task Forca për Integrimi Europiane e udhëhequr nga Ministria e Integrimin Europian 3) Komisioni për Integrimi Europiane i Kuvendit të Kosovës 4) Ministria e Integrimin Europian, kryesisht për programimin e asistencës financiare dhe zbatimin e projekteve nga fusha e edukimit dhe komunikimit e informimit.

Këshilli Kombëtar për Integrim European i udhëhequr nga Presidenca (KKIE) - është forum konsultativ dhe koordinues i cili synon formulimin e politikave konsensuale kombëtare të Republikës së Kosovës për integrim european, duke lehtësuar koordinimin e aktiviteteve të të gjitha palëve të përfshira. Këshilli është formuar dhe udhëhiqet nga Presidentja e Kosovës. Funkcionet e Këshillit janë: të përcaktojë kornizën strategjike të procesit të integritit european të Republikës së Kosovës; të ofrojë një forum koordinues dhe unifikues të gjitha palëve kyçe në procesin e integritit european me qëllim të sigurimit të përkrahjes së nevojshme politike dhe shoqërore për zbatimin e reformave të nevojshme; të monitorojë progresin e Republikës së Kosovës drejt integritit në Bashkimin European dhe të ofrojë kontributin e nevojshëm me qëllim të përmbushjes së agjendës europiane. Në këtë strukturë shoqëria civile është e përfaqësuar me tre anëtarë. Përfaqësuesit e shoqërisë civile janë përzgjedhur pas një procesi të hapur të nominimit. Tre përfaqësuesit e shoqërisë civile vijnë nga organizata me përvojë dhe projekte nga fusha e integritit european si KCSF dhe KFOS, ose përfaqësojnë rrjete me ndikim në Kosovë sikur platforma Civikos.

Task Forca për Integrim European – është mekanizëm kombëtar i zhvillimit të konsensusit që synon të mbledh ekspertë të ndryshëm nga mbarë strukturat qeveritare dhe jo-qeveritare të vendit me qëllim të diskutimit dhe analizës së gjithmbarshme të gjendjes momentale, dhe të sfidave që duhet adresuar në kuadër të procesit të integritit european. Task Forca ka për qëllim të shumëfishojë përpjekjet dhe angazhimin nëpërmes pjesëmarrjes dhe kontributit të gjithë aktorëve në qeverisje, politikë, jetën akademike, publik, shoqëri civile, media, dhe të tjerë me interes në proces të integritit european. Kjo po bëhet përmes organizimit të punës në 7 Tryeza Tematike. Në këtë strukturë ftohen përfaqësuesit e shoqërisë civile bazuar në ekspertizën e tyre në sektorë të caktuar për të kontribuar dhe parashtruar shqetësimet e tyre, ndërsa disa nga tryezat tematike edhe udhëhiqen nga ekspertë që vijnë nga shoqëria civile. Duke u bazuar në sfidat e dala nga Tryezat Tematike, Task Forca do të dalë me rekomandime konkrete për politikën strategjike mbi procesin e integritit european. Synimi kryesor i Task Forcës është zhvillimi i Strategjisë Nacionale për Integrim European.

Komisioni për Integrim European i Kuvendit të Kosovës – fton organizatat e shoqërisë civile që të marrin pjesë në takimet e hapura të këtij komisioni ku OShC-të kanë rastin të mbikëqyrin punën e këtij komisioni në raport me përafrimin e legjislacionit të BE-së në atë të Kosovës. Për më shumë, Komisioni ka nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi me disa OShC të specializuara dhe shpeshherë disa prej tyre janë kontraktuar për tu ofruar ekspertizën e tyre për këtë Komision.

Ministria e Integritit European (MEI) – që nga viti i kaluar i fton organizatat e shoqërisë civile në programimin e IPA-s, ku përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë rastin të informohen për dhe komentojnë projektet e propozuara nga Qeveria e Kosovës për financim nga IPA. Poashtu MEI bashkëpunon me OShC-të e ndryshme përmes kontraktimit të tyre për aktivitete të edukimit, ngritjes së kapaciteteve dhe zbatimin e projekteve nga fusha e komunikimit dhe informimit për BE-në.

Duke njohur faktin që jo vetëm organizatat jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-të) bëjnë pjesë në shoqëri civile, termi OShC u referohet të gjitha formave të organizuara të shoqërisë civile. Termi OJQ, në këtë dokument, përdoret vetëm në rastet kur flitet për dispozitat konkrete ligjore të cilat u referohen konkretisht organizatave jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-ve).

ORARI I PUNËS
 e hënë – e premte
 10:00 deri 14:00



Qendra ofron si dhe i përgjigjet çdo kërkesë për informacion për nevojat e organizatave të shoqërisë civile (OShC), qytetarëve të interesuar, institucioneve publike dhe organizatave donatore për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

QËLLIMI I QENDRËS:

- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit
- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes
- Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit rreth sektorit të shoqërisë civile
- Krijimi i instrumenteve për mbledhjen dhe analizën e vazhdueshme të të dhënave për sektorin e shoqërisë civile dhe fusha të veçanta të këtij sektori
- Ngritja e kapaciteve të OShC-ve dhe institucioneve publike për bashkëpunimin ndërsektorial
- Promovimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë në qeverisjen e mirë të brendshme të OShC-ve

ÇKA OFRON QENDRA?

- **Deskun e informacionit** i cili i përgjigjet çdo kërkesë për informacion rreth sektorit të shoqërisë civile dhe pranon kërkesat e OShC-ve për trajnime, përkrahje dhe mentorim
- **Trajnime bazike dhe të avancuara** për pjesëtarët e OShC-ve, në baza të rregullta ose në bazë paraqitjes së kërkesës nga ana e OShC-ve
- **Shërbimin e këshillimit gjatë punës dhe mentorimit** që ofron këshillim dhe mentorim në punën e përditshme të OShC-ve në bazë të kërkesës së tyre
- **Këndin e informacionit** ku vizitorët mund të marrin informata rreth sektorit të shoqërisë civile dhe broshura e artikuj informues për këtë sektor
- **Këndin e leximit** që mund të presë deri në 10 vizitorë
- **Këndin e bibliotekës** ku vizitorët mund të gjejnë libra dhe artikuj nga fusha e zhvillimit të shoqërisë civile dhe procesit të integritimit evropian
- **Sallën** e pajisur me të gjitha elementet me kapacitet deri në 25 persona

CILAT JANË RREGULLAT PËR VIZITORË?

Broshurat dhe fletushkat jepen falas për të gjithë vizitorët

Librat, buletinët dhe publikimet tjera mund të lexohen vetëm brenda Qendrës

Të gjithë të interesuarit për shërbimet e Qendrës duhet të kontaktojnë deskun e informacionit, me shkrim apo drejtpërdrejtë